



VENDIM

Nr. 15, Datë 19.01.2017

MBI

FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MODIFIKIMIN E LIÇENCËS SË SHOQËRISË “KOMP ENERGJI” SH.P.K, ME NUMËR 253, SERIA T14P, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT NR.102, DATË 07.11.2014, PËR TREGTIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16; 20, gërma “b” dhe 43, pika 1, të Ligjit nr. 43/2015, *Për Sektorin e Energjisë Elektrike*”, nenit 113 të Ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurës Administrative në Republikën e Shqipërisë”*; VKM-së Nr. 840, datë 11.06.2008 *“Për përcaktimin e Autoritetit Kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Vinjoll”*; neneve 10 dhe 15 të *“Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Liçensave në Sektorin e Energjisë Elektrike”*, miratuar me vendimin nr. 109, datë 29.06.2016, të Bordit të ERE; nenit 19, pika 1, gërma “a” të *“Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”* miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 19.01.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut në lidhje me modifikimin e licensës së aktivitetit të tregimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Komp Energji” sh.p.k,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Komp Energji” sh.p.k, është liçencuar në aktivitetin e Tregimit të Energjisë Elektrike për një afat 30 vjeçar, me licensën numër 253, Seria T14P, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.102, datë 07.11.2014.
- Referuar shkresës nr. 791, Prot, datë 11.11.2016, të nënshkruar nga administratori i konçensionarit “Komp Energji” sh.p.k dhe administratori i shoqërisë konçesionare “Hidropowerplant Construction” sh.p.k, është kërkuar zëvendësimi i emrit të konçensionarit “Komp Energji” sh.p.k, me emrin e shoqërisë konçesionare “Hidropowerplant Construction” sh.p.k, vetëm për liçencën e Prodhimit të Energjisë Elektrike.
- Meqëse liçenca e Tregëtimit të Energjisë Elektrike është e lidhur kryesisht me aktivitetin e prodhimit të Hec-ve “Hurdhas 1”, “Hurdhas 2” dhe “Hurdhas 3”, është e nevojshme të bëhet edhe modifikimi i liçencës të

Tregëtimin të Energjisë Elektrike në favor të shoqërisë koncesionare
“Hidropowerplant Construction”sh.p.k.”

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për modifikimin e licencës me numër 253, Seria T14P, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 102, datë 07.11.2014, për Tregëtimin e Energjisë Elektrike, të mbajtur nga Konçesionari Komp Energji” sh.p.k. .
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.